



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:206370

Datë: 02.10.2024

Numri i dokumentit: 06244899

Ac. 2806/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses T. M. nga V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.K. nga P., kundër të paditurës K. e S. “E.”, me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E.N.-B., me objekt të kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2479/2016 të datës 16.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.09.2024, mori këtë

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e paditëses T.M. nga V., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 2479/16, i datës 16.11.2020, në pikën I dhe III të dispozitivit përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim:
APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses T. M. nga V., DETYROHET e paditura K. e S. “E.” me seli në P., që paditëses në emër të kompensimit të dëmit në aksidentin e shkaktuar me datë 17.08.2016, në emër të dëmit jo material t’i paguaj shumat si vijon:
- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....6,500€
 - Për frikën e përjetuar, shumën prej.....4,500€
 - Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....10,500€
 - Për shëmtim trupor, shumën prej.....3500€, të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, nga data 16.11.2020, si datë e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e deri në pagesën përfundimtare. Ndërsa kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e dëmi jo material, përtej shumës së gjykuar, REFUZOHET si e pabazuar.

- II. REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditëses në drejtim të pikën të dispozitivit I, II dhe III të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 2479/16, datë 16.11.2020, në pjesën e gjykuar në emër të kompensimit të dëmit material për shpenzime mjekësore dhe rehabilitim fizioterapeutik, si dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore, ashtu që aktgjykimi në këtë pjesë VËRTETOHET
- III. Aktgjykimi i ankimuar në pikën I të dispozitivit përkitazi me kompensimin e dëmit material në emër të rentës së gjykuar, ushqimit të përforcuar dhe përkujdesjes të personit të huaj, *mbetet i pa shqyrtuar.*

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2479/2016 të datës 16.11.2020, ka vendosur si në vijim:

“I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëses T.M. nga V. , dhe DETYROHET e paditura K. e S. ”E.” me seli në P., që paditëses në emër të kompensimit të dëmit në aksidentin e shkaktuar me datë 17.08.2016, t’ia paguajë shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....4,000€

Për friken e pësuar, shumën prej.....3,000€

Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....8,000€

Për shëmtim trupor, shumën prej.....2,500€

Në emër të dëmit material:

Në emër të kompensimit për rentën e arritur, për periudhën nga data 17.08.2016 e deri me datën 30.06.2020, për 24.081% të zvogëlimit të aftësisë punuese, t’ia paguaj shumën prej 2,450.00€, kurse kompensimi për periudhën e ardhshme prej datës 01.07.2020 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore rentën mujore nga 59.69€ në muaj.

Për shpenzime mjekësore në emër të shërimit dhe rehabilitimit fizioterapeutik- klimatik shumën prej20.79€

Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....700€

Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej500€

II. DETYROHET e paditura K. e S. “E.” me seli në P., që paditëses t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të padisë, nga data e marrjes së aktgjykimit 16.11.2020 e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e

procedurës në lartësi prej 1,544€, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit.

III. REFUZHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses T.M. , mbi shumat e aprovuara dhe atë: për dhembjet e përjetuara fizike shumën prej 8,000€; për frikën e pësuar shumën prej 6,000€; për shëmtim trupor shumën prej 4,500€; për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 7,000€; për shpenzime mjekësore dhe rehabilitim fizioterapeutik- klimatik shumën prej 2,201.21€.”

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, ka parashtruar ankesë dhe atë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e palës paditëse dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj në drejtim të rritjes së shumës së kompensimit dhe shpenzimeve procedurale.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala e paditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes të autorizuarit të saj me datë 20.10.2016 ka parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë kundër të paditurës, për shkak të dëmit jo material dhe material të pësuar në aksidentin e komunikacionit, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe bazuar në provat materiale të administruara, ka marrë aktgjykimin C.nr.2479/16 të datës 16.11.2020, me anë të së cilit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar.

Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimin, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se nga deklaratimet e ndërgjyqësve dhe shkresat e lëndës ka rezultuar se mes palëve nuk ishte kontestues fakti se shkaktari i aksidentit të komunikacionit i cili ka ndodhur me datë 17.08.2016 në Magjistralen P. – M., nga ka rrjedhur si pasojë dëmi, të ketë qenë i siguruar tek e paditura, pra nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë. Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësja në emër të kompensimit ka pranur akontacionin nga e paditura shumën prej 1000€. Në këtë drejtim, gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë,

Meqë mes palëve ndërgjyqëse kontestues ishte lartësia e kompensimit, prandaj gjykata për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertimit me ekspertë nga lëmia e ortopedisë, të cilën e ka punuar Dr. Xh.S., me ekspert psikiatër të punuar nga Dr. F. D., me ekspert oftamolog të punuar nga Dr. N. S. dhe me ekspert urolog të punuar Dr. S.M..

Eksperti ortoped në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor ka konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si lëndime të rënda trupore. Është konstatuar se paditësja dhimbje me intensitet posaçërisht të lartë ka pasur për 30 minuta, dhimbje me intensitet të lartë 48 orë, me intensitet të mesëm 6 javë, ndërsa me intensitet të ulët ende ekzistojnë edhe sot, të cilat manifestohen si dhimbje të krahut të djathtë, harkut brinjor të majtë dhe dhimbjet e kofshës së djathtë. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti

ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 120 ditëve, duke përfshirë ndihmën në mbajtjen e higjienës, veshmbathjeve, ushqimit. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 180 ditë, i pasur me proteina, minerale, vitamina etj. Kurse rehabilitimi fizikoterapeutik ka qenë i nevojshëm për 30 ditë brenda vitit të parë dhe 30 ditë tjera brenda vitit të dytë pas aksidentit. Eksperti ka gjetur se paditësja ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 21.21%, për shkak të thyerjeve që ka pësuar, gjakderdhjeve në mushkëri, kufizimit të lëvizjeve të gjurit të djathtë. Prandaj për këtë kategori të dëmit është caktuar shuma e kompensimit në lartësi prej 8.000€. Në emër të shëmtimit gjykata e shkallës së parë ka caktuar shumën e kompensimit prej 2.500€, ngase është vërtetuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka pasur edhe shëmtim në shkallë të mesme. Për frikën gjykata e shkallës së parë ka caktuar shpërblimin në shumë prej 3.000 € si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësja sipas mendimit të ekspertit psikiatër, në mendimin e tij lidhur me frikën ka pasqyruar se paditësja si pasojë e aksidentit të shkaktuar, ka përjetuar intensitete frike të llojeve të ndryshme.

Me qëllim të vërtetimit nëse paditësja ka pasur lëndim të syve, ashu siç ka pohuar, gjykata ka nxjerrë ekspertizën nga lëmia e oftalmologjisë. Në mendimin e tij eksperti ka arritur në përfundim se paditësja si pasojë e aksidentit i janë shkaktuar lëndime sipërfaqësore në lëkurën e kapakëve si dhe regjionit rreth syrit në formë të gërvishjeve, si dhe gjakderdhje nënlëkurore të shoqëruara me enjtje, të cilat kanë qenë pa pasoja të përhershme për sytë. Lëndimet e syve, konsiderohen si lëndime të lehta trupore.

Për të përcaktuar shkallën e zvogëlimit të aftësisë punuese, është nxjerrë ekspertiza nga lëmia e punës, të cilën e ka punuar Dr. K. Z. Përmes kësaj ekspertize gjykata e shkallës së parë gjeti se paditësja është e pa aftë për vende të punës ku kërkohet pozitë e detyruar e trupit apo pjesëve të trupit, qëndrimi i gjatë në këmbë, bartja e peshës mbi 1 kg, pasi që sipas ekspertit paditësja ka zvogëlim të aftësisë punuese prej 24.81%. Si rezultat i vërtetimit të gjendjes faktike për sa i përket zvogëlimit të aktivitetit punues, përmes ekspertizave mjekësore, sipas propozimit të palëve gjykata për të vërtetuar lartësinë e kompensimit që i referohet që i referohet fitimit të humbur – rentës, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare të cilën e ka punuar A. B.. Sipas ekspertizës aktuaristike, lartësia e kompensimit për paditësen për rentën e arritur, për periudhën e kaluar prej ditës së aksidentit 17.08.2016 e deri me datën 30.06.2020 (si datë e nxjerrjes së ekspertizës financiare) është në shumën prej 2,450€, ndërsa kompensimi për periudhën e ardhshme prej datës 01.07.2020 e në të ardhmen, deri sa për këtë të ekzistojnë kushte ligjore nga 59.69€ në muaj. Gjukata e shkallës së parë ekspertizat mjekësore atë të ortopedisë, psikiatrisë, oftalmologjisë, mjekësisë së punës, si dhe aktuaristikës i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu të punuara sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kompenimin e dëmit jomaterial gjykata e mbështeti në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, Nenin 137 i LMD-së ku parashihet se: *Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i*

dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe mungesa e dëmit material.

Lidhur me mënyrën e vendosjes që ka të bëjë me rentën, gjykata e shkallës së parë ka aplikuar dispozitën e nenit 172 par. 1 të LMD-së ku përcaktohet se: *Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar.* Kurse për pagesën e rentës mujore gjykata e shkallës së parë aplikoi nenin 172 par. 1, sipas të cilit: *Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër, e caktuar në shumë 59.69€, për çdo muaj e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në përpjesëtim me shkallën e zvogëlimit të aftësisë punuese.* Gjykata vlerësoi se shumat e kompensimit të aprovuara janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj paditëses satisfaksion që ajo të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar.

Për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj, vlerësoi se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore, dhe vështirë i argumentuar. Andaj me çmuarje të lirë dhe konform nenit 323 të LPK-së ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave. Për sa i përket kategorisë së dëmit material në emër të shpenzimeve mjekësore, rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik, përmes faturave që i janë bashkangjitur padisë, është vërtetuar se shuma e tyre arrin vlerën prej 1020.79€, kurse pjesa tjetër përtej kësaj shume nuk ka mbulesë në prova-fatura.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin material dhe jo material gjykata vendosi si në piken III të dispozitivit të aktgjykimit pasi vlerësoi se kompensim përtej shumave të gjykuar, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, gjithashtu duke pasur parasysh shumën e akontacionit të pranuar në shumë prej 1000€, të pranuar nga paditësja.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi t kryesor, edhe kamatën.* Kamata është llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit, gjegjësisht prej datës 16.11.2020 e gjerë në pagesën definitive. Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i paditëses se aktgjykimi i ankimuar është rezultat i gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar, ngase gjykata e shkallës së parë nga deklarimet e ndërgjyqësve dhe me referim në provat shkresore drejtë ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese, ndërsa lidhur me lartësinë e dëmit i ka administruar të gjitha provat e propozuara duke nxjerrë ekspertizë mjekësore për të vërtetuar natyrën e lëndimit dhe pasojat e lëndimit. Ekspertët mjekësore kanë sqaruar në mënyrë profesionale të gjitha kategoritë e dëmit, natyrën dhe llojin e lëndimeve, intensitetin dhe

kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shkallën e shëmtimit trupor, të cilat ekspertiza i ka vlerësuar edhe kjo gjykatë si të besueshme, por që nga gjendja e vërtetuar faktike, është zbatuar gabimisht e drejta materiale në pjesën e kërkesëpadisë, ku aktgjykimi është dashur të ndryshohet përkitazi me kërkesëpadinë për kompensimin e dëmit jo material. për faktin se kjo gjykatë konsideron se përcaktimi i kompensimit në shumën e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë për këto kategori të dëmit është e ulët dhe nuk përkon më rëndësinë e të mirës së cenuar.

Lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit jo material për dhimbje fizike, Gjykata e Apelit mori posaçërisht parasysh konstatimet e ekspertit ortoped se natyra e lëndimit është e rëndë, për shkak të frakturës së femurit në këmbën e djathtë, të klavikulës djathtas, frakturës së brinjës së IV djathtas me mbledhje lëngu në mushkërinë e djathtë dhe ndrydhje gjakderdhëse në mushkërinë e majtë. Gjithashtu gjykata e shkallës së dytë ka pasur parasysh edhe konstatimet e ekspertit oftamolog lidhur me lëndimet sipërfaqësore në lëkurën e kapakëve të syrit, gërvishjet në regjionin rreth syrit dhe gjakderdhjes nënlëkurore të kualifikuar si lëndim i lehtë trupor. Mbi bazën e këtyre konstatimeve dhe duke marrë parasysh intensitetin e dhimbjeve trupore që ka përjetuar paditësja, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se shumica e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk përkon me të mirën e shkelur dhe me shumicën e gjykuara, nuk arrihet qëllimi i kompensimit. Përkitazi me frikën, kolegji i kësaj gjykate aktgjykimin e atakuar e ndryshoi me referim në ekspertizën e psikiatrisë ku konstatohet se paditësja ka përjetuar frikë primare për disa sekonda, ndërsa pas kthimit të vetëdijes ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë e që ka zgjatur 13 ditë derisa ka qëndruar në Klinikë, ndërsa frika sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur për tetë javë tjera.

Në caktimin e lartësisë në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore, si pasojë e shëmtimit dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm mjekësor, kolegji i kësaj gjykate ka pasur për bazë konstatimet e ekspertëve mjekësor ku përcaktohet se shëmtimi trupor është i shkallës së mesme për shkak të vrazës operatorë në pjesën e sipërme të kofshës së djathtë me gjatësi prej 6.5cm, vrazës operatorë të pjesës së poshtme të kofshës së djathtë me gjatësi prej 8cm, dy vrazë në bërrylin e majtë, një vrazë në pjesën zverkore të majtë të kokës me gjatësi prej 1.5cm dhe tjetra në pjesën ballore në gjatësi prej 3cm. Ndërsa zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është në shkallë prej 21.21%. Prandaj nga kjo gjendje faktike Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kompensimin e dëmit jo material për këto kategori të dëmit pasi që vlerësoi se shumica e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë janë të ulta në krahasim me natyrën, me peshën dhe pasojat e lëndimit nga aksidenti i komunikacionit, ku paditësja ishte vetëm si bashkëdhëtare në automjetin e siguruar te e paditura. Kështu e drejta e paditësës për kompensimin e këtyre kategorive të dëmit jomaterial gjen mbështetje në dispozitat e nenit 9 dhe 10 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia lidhur me nenin 137 dhe 183 të LMD, ku përcaktohet dëmi jo material dhe shpërblimi i drejtë për rastet e lëndimeve trupore, frikës së përjetuar dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm dhe shëmtimit, lidhur me të cilat baza është paraqitur edhe padia konkrete nga ana e paditësës.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur për kumatën e gjykuar, pasi është në përputhje të plotë me dispozitën e ligjit material të nenit 382 të LMD, me normën e interesit vjetor në shkallë 8%, siç përcaktohet në dispozitën ligjore të aplikuar drejtë në aktgjykimin e atakuar.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i drejtë dhe në përputhje me dispozitën e nenit 453 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore, andaj rrjedhimisht edhe pretendimet ankimore të paditësit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale përkitazi me shpenzimet e procedurës është e pa bazuar.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për paditësen dhe atë për shpenzimet e rehabilitimit klimaterik dhe shpenzimet e mjekimit, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këto kategori të dëmit gjen mbështetje në nenin 137 të LMD-së. Në këtë rast paditësja si pasojë e aksidentit ka pasur shpenzime të mjekimit dhe rehabilitimit fizioterapeutik, e lartësia e tyre është vërtetuar me prova materiale si në shkresat e lëndës të cilët janë administruar nga gjykata e shkallës së parë nga të cilat prova ka rezultuar se pas zbritjes së shumës në emër të paradhënies (akontacionit) prej 1000€, dëmi material është në shumë prej 20.79€, pra në lartësin për të cilën ka vendosur drejtë gjykata e shkallës së parë në vendimin e atakuar përkitazi me detyrimin e të paditurës për shumën e detyrimit material për këtë kategori të dëmit.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me shumën e gjykuar në emër të dëmit material për rentën e arritur, rentën për periudhën e ardhshme, për ushqim të përforcuar dhe për përkujdesje të personit të huaj, nuk është shqyrtuar nga e kësaj gjykate, pasi nuk ka pasur ankesë në këtë drejtim.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të dispozitës së nenit 194, 195 par.1 pika d) dhe e) lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2806/2021, me datë 25.09.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli